

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

FAKULTETI I FILOLOGJISË I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “Hasan Prishtina”

Prishtinë, Rruga Nënë Tereza, pn. KOSOVË

Tel. +38138 222 970

E-mail: seminari.fiologjik@uni-pr.edu, bardhrugova@yahoo.com

Drejtor: Prof.dr. Bardh Rugova

Sekretar: Prof. asoc. dr. Abdullah Rexhepi

Sekretareprofesionale: Jeta Abazi MA, Liridona Bërkolli MA

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studente/ë e studiues/e që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht.

Seminari ka zhvilluar gjithsej dyzet sesione. Në vitin 1991 është ndërprerë veprimtaria e tij nga organet serbe. Në vitet 1995 e 1996 sesionet e këtij Seminarit u mbajtën në Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga viti 2000 Seminarit vepron sërish në Prishtinë. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001) janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Më 2020 qe ndërprerë aktiviteti, për shkak të pandemisë Covid 19.

SEMINARI XLI DO T’I ZHVILLOJË PUNIMET NË PRISHTINË NGA 14 gusht – 25 gusht 2023

Arrija e seminaristëve në Kosovë, më 13 gusht 2023 (e diel). Hapja solemne e Seminarit XLI, më 14 gusht 2023 në orën 11:00.

Programi bazë i Seminarit XLI:

1. Kurse intensive të mësimit të shqipes (tri shkallë);
2. Ligjërata të veçanta të gjuhësisë;
3. Ligjërata për letërsinë shqiptare;
4. Referime shkencore;
5. Ligjërata të përgjithshme;
6. Tryezë e rumbullakët;

7. Program kulturor plotësues për t’i njohur seminaristët me bukuritë natyrore, me veprimtari të kulturore e të mira të tjera në ambiente shqiptare;

SESIONI SHKENCOR (24 – 25 gusht 2023)

- Shqipja në rrezik
- Letërsia shqipe dhe interkulturalizmi

PARAQITJA DHE REGJISTRIMI

Mbiemri e emri
Datëlindja, vendlindja
Seksi
Profesioni
Kombësia.....
Vendi (shteti)
Adresa e saktë
Cilin kurs të shqipes do të ndiqni.....
A do të paraqitni kumtesë ose referim shkencor?
Tema

Drejtorja e Seminarit do t’i mbulojë shpenzimet e vendosjes dhe të ekskursioneve eventuale në Kosovë. Shpenzimet e rrugës për Prishtinë dhe e kundërta i heqin vetë pjesëmarrësit. Paraqitja për të marrë pjesë në Seminarin XLI duhet të arrijë në Drejtori të Seminarit deri më 15qershor 2023 në një prej adresave të sipërsënuara.

Drejtorja e Seminarit

THE INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE

FACULTY OF PHILOLOGY OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA “Hasan Prishtina”

Mother Theresa, st, nn., Prishtina, KOSOVA

Tel. +38138 222 970

E-mail: seminari.filologjik@uni-pr.edu, bardhrugova@yahoo.com

Director: Prof.Dr.BardhRugova

Secretary: Prof. Assoc. Dr. Abdullah Rexhepi

Professional Secretary:Jeta Abazi MA, LiridonaBërkolli MA

The International Seminar on Albanian Language, Literature and Culture was founded in 1974 at the Faculty of Philology (Faculty of Philosophy at that time) of the University of Prishtina. This seminar is organized for the students, professors and researchers outside Kosova and Albania engaged in the Albanian sciences and in Albanology in general.

The Seminar has so far organized 40 Sessions. In 1991 the imposed Serbian rule discontinued the activities of the Seminar. In 1995 and 1996, in co-operation with the Institute of Linguistics and Literature of the Academy of Sciences and Arts of Albania, the Seminar was forced to develop its activities in Tirana. Since the year 2000 the Seminar performs its activities in Prishtina. The 19th and the 20th sessions were organized in cooperation with the Institute of Linguistics and Literature of the Academy of Sciences of Albania. In 2020, its activities were discontinued due to Covid 19 pandemic.

THE 41st SEMINAR WILL DEVELOP THE ACTIVITIES IN PRISHTINA FROM 14August – 25 August 2023

The arrival of the participants in Kosova– 13August 2023 (Sunday).The opening ceremony of the Seminar is on 14August at 11:00 AM.

The basic program of the 41stSeminar:

1. Intensive courses of the Albanian language (three levels);
2. Particular lectures in Albanian linguistics;
3. Lectures in Albanian literature;
4. Scientific references;
5. General lectures;
6. Round table;

7. Additional cultural program aiming to show the participants the natural beauties of Kosovo and the activities in other centers;

COLLOQUIUM (24 - 25 August 2023)

- **Endangered Albanian**
- **Albanian Literature and Interculturalism**

APPLICATION AND ENROLLMENT

Name and surname
Date and place of birth.....
Sex.....
Profession.....
Nationality.....
Country.....
Address.....
Would you like to present a scientific paper or reference?
The subject.....

The Directory of the Seminar will take over the expenses for accommodation and eventual excursions in Kosova. The travel expenses to and from Prishtina, must be covered by the participants themselves.The application for participation at the 41st Seminar should arrive to the Directory by 15th June2023 in one of the announced addresses.

Directory of the Seminar